

## Aktiviteti USAID Kosovo Compete

### Kërkesë për Aplikime (KPA)

Data e lëshimit	E hënë, 25 nëntor 2024
Afat i fundit për pranimin e pyetjeve	E premte, 6 dhjetor 2024, deri në 17:00 sipas kohës lokale
Sesioni informues	E hënë, 9 dhjetor 2024, prej 11:00 – 12:30 <u>Lokacioni:</u> Zyra e Aktivitetit të USAID-it për Konkurrencën në Kosovë në Rr. <i>Ukshin Hoti</i> , Nr. 120, Objekti C3/3/b, Kati 1 <u>Online:</u> përmes <a href="#">Microsoft teams</a>
Data/Ora për dorëzimin e aplikacioneve	E mërkurë, 8 janar 2025, deri në 17:00 sipas kohës lokale
Titulli	Kërkesë për aplikime (KPA) për “ <b>Nxitja e rritjes së tregut përmes diversifikimit</b> ”

#### Pasqyrë përbledhëse

Aktiviteti USAID Kosovo Compete (në tekstin e mëtejshmë “USAID Compete”, “Compete” “Aktiviteti” ose “Projekti”) financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Aktiviteti zbatohet nga DT Global. Projekti është dizajnuar për ta lehtësuar përmirësimin e gjerë të sektorit në konkurrencën e eksportit të sektorit privat në sektorët kryesorë të përpunimit të drurit, përpunimit të ushqimit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

Kjo Kërkesë për Aplikime (KPA) synon ta avancojë praninë në tregun ndërkombëtar të sektorëve kyç të Kosovës, duke përfshirë përpunimin e drurit, përpunimin e ushqimit, TIK-un dhe ndërtimin e shtëpive të parafabrikuara. Përmes aktiviteteve të synuara të granteve, kjo KPA synon t'i fuqizojë kompanitë në këta sektorë me mjetet dhe strategjitë e nevojshme për të pasur sukses në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht tregjet jo-tradicionale për eksportuesit Kosovarë duke siguruar integrim afatgjatë dhe të qëndrueshëm në treg.

Objektivat kryesore të kësaj KPA-je janë të përmirësohet gatishmëria për eksport, të përsosen strategjitë e çmimeve dhe pozicionimit dhe të përdoren njohuritë rreth tregut për ta nxitur rritjen strategjike në të katër sektorët. Duke e shfrytëzuar qasjen në treg për t'i lidhur bizneset me mundësi të reja në tregje të reja dhe sofistikimin e biznesit për t'i përmirësuar aftësitë operative dhe pozicionimin në treg, kjo nismë synon të nxisë partneritete strategjike, të promovojë shkëmbimin e njohurive dhe t'i vendosë produktet dhe shërbimet e Kosovës në tregje të reja përmes bashkëpunimit gjithëpërfshirës të mbarë sektorit.

Më konkretisht, programi do t'i ndihmojë NVM-ve në përshtatjen e ofertave të tyre për t'i përbushur standardet ndërkombëtare, për ta rritur efikasitetin funksional dhe për ta nxitur krijimin e aleancave të industrisë për ta zgjeruar shtrirjen e tregut.

Grantet do të jepen dhe zbatohen në përputhje me rregulloret e qeverisë së SHBA-ve që i rregullojnë grantet me kontrata dhe politikat e brendshme të menaxhimit të granteve të Projektit. Aplikanti (aplikantët) e suksesshëm do të janë përgjegjës për të siguruar arrijet e objektivave të specifikuara të grantit. Ju lutemi referojuni Pjesës 1 - Përshkrimi i mundësive të financimit - për ta parë pérshkrimin e plotë të qëllimeve dhe rezultateve të pritshme.

Kjo KPA përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- Pjesa 1 – Përshkrim i mundësisë për financim
- Pjesa 2 – Informata rreth grantit
- Pjesa 3 – Informata rreth kualifikimit
- Pjesa 4 – Sesioni informues
- Pjesa 5 – Informata rreth aplikimit dhe dorëzimit të aplikacionit
- Pjesa 6 – Informata rreth vlerësimit të aplikacionit
- Pjesa 7 – Informata rreth dhënies dhe administrimit të grantit
- Pjesa 8 – Shtojcat (Formulari i aplikimit dhe Shabloni i buxhetit)

Në bazë të 2 CFR 200 Nënpjesa E dhe 2 CFR 700.13, është politikë e USAID-it që të mos japë financim në kuadër të instrumenteve të asistencës. Megjithatë, të gjitha shpenzimet e arsyeshme, të ndara dhe të lejueshme, direkte dhe indirekte që lidhen me aktivitetin e grantit dhe janë në përputhje me standardet e aplikueshme të kostos (2 CFR 200 Nënpjesa E për organizatat joftimprurëse dhe institucionet arsimore dhe Rregullorja Federale për Blerjet (FAR) Pjesa 31 për organizatat fitimprurëse), mund të paguhen në kuadër të Grantit.

**Aktiviteti USAID Kosovo Compete synon të ofrojë grante në shumën deri në 80,000 EUR. Partnerët zbatues të synuar të këtyre aktivitetave të granteve janë bizneset lokale, organizatat lokale, shoqatat e biznesit, firmat e konsulencës, organizatat/bizneset me bazë në diasporë, ose konsorciumet e kompanive të afta për t'i zbatuar aktivitetet në mënyrë efektive brenda kornizës kohore katër muajshe.**

Projekti rezervon të drejtën për t'i financuar të gjitha ose asnjë prej aplikacioneve të paraqitura. Lëshimi i kësaj KPA-je nuk përbën zotim për dhënien e grantit nga ana e USAID Kosovo Compete dhe as nuk e obligon Projektin të paguajë për kostot e shkaktuar në përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacioneve. Më tej, Aktiviteti USAID Kosovo Compete rezervon të drejtën ta refuzojë një ose të gjitha aplikacionet e pranuara nëse një veprim i tillë konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të Qeverisë së SHBA-ve. Aplikantët i bartin vetë rreziqet e aplikimit; nëse rrethanat e pengojnë marrjen e një granti, të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit barten nga aplikanti.

Çdo pyetje në lidhje me këtë RFA aplikantët duhet të paraqesin me shkrim përmes emailit në [kosovogrants@dt-global.com](mailto:kosovogrants@dt-global.com). Afati i fundit për pranimin e kërkesave për

sqarime/shpjegime është të premten, 6 dhjetor 2024, deri në orën 17:00 sipas kohës lokale. Asnjë pyetje nuk do të pranohet pas kësaj date. Për aplikantët e interesuar do të mbahet një sesion informues të hënën, më 9 dhjetor 2024, nga ora 11:00 – 12:30, në zyrën e USAID Kosovo Compete në Prishtinë, Kosovë (e shënuar më poshtë). Sesioni informues mund të ndiqet edhe virtualisht përmes këtij linku në [Microsoft Teams](#).

Aplikantët duhet t'i dorëzojnë aplikimet përmes email adresës në kosovogrants@dt-global.com me titullin [RFA#03-2024](#). Data e fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **e mërkure, 8 janar 2025** dhe ora e fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 17:00 sipas kohës lokale. Aplikacionet e vonuara nuk do të merren parasysh.

## **Pjesa 1 – Përshkrim i mundësisë për financim**

### ***Qëllimi i përgjithshëm***

Qëllimi i Aktivitetit USAID Kosovo Compete përmes kësaj AKP-je është ta rrisë praninë në tregun ndërkombëtar dhe konkurrencën e eksportit të sektorëve kyç të Kosovës; Përpunimi i drurit, përpunimi i ushqimit, TIK-u dhe ndërtimi i shtëpive të parafabrikuara. Aktivitetet e granteve kanë për qëllim: (i) T'iu ndihmojnë kompanive kosovare në hyrjen në tregje të reja ndërkombëtare. (ii) Të rriten aftësitë e bizneseve duke krijuar partneritet me ofrues shërbimesh me përvojë. (iii) Të promovohet rritja e qëndrueshme për bizneset kosovare dhe akterët e tjera kryesore në sektorin e përgjedhur. Kurdo që është e mundur, përfituesit duhet të përfshijnë përfitues të udhëhequr nga grupe të pafavorizuara, si gratë dhe pakicat. Për më tepër, grantet mund të fokusohen në shkallëzimin e nismave të testuara në treg, të cilat janë programe ose strategji të provuara që kanë demonstruar sukses në arritjen e rezultateve të dëshiruara. Duke ofruar mbështetje të synuar për t'i zgjeruar nismat e suksesshme, programi synon të ndërtojë sisteme të qëndrueshme të tregut, ta nxisë rritjen ekonomike dhe ta pozicionojë Kosovën si lojtar konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

### ***Hyrje***

USAID Compete është aktivitet pesëvjeçar që ka filluar më 11 gusht 2020. Qëllimi i USAID Compete është të promovojë sisteme të qëndrueshme, të pavarura të tregut dhe ta lehtësojë konkurrencën e përmirësuar të sektorit privat në tregjet lokale, rajonale dhe globale. Aktiviteti bazohet në një qasje të sistemit të tregut të harmonizuar me Politikën e USAID-it për Angazhimin e Sektorit Privat.

USAID Compete fokusohet në katër sektorë të orientuar nga eksporti për ta rritur në mënyrë të qëndrueshme konkurrencën:

- Përpunimi i ushqimit
- Teknologjitet e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
- Përpunimi i drurit,
- Sektori i shtëpive të parafabrikuara/Shtepitë Modulare

Duke punuar për t'i adresuar kufizimet në të gjithë sistemin, USAID Compete kërkon të mundësojë ndryshime të shkallëzuara dhe sistematike, duke stimuluar krijimin e vendeve

të punës dhe duke e rritur aftësinë e sektorit privat për t'u integruar në tregjet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Fushat kryesore të ndërhyrjes përfshijnë: (a) Qasjen në treg (b) Financime të ndryshme (c) Sofistikim të biznesit (d) Zhvillim të aftësive (e) Mjedis mbështetës të biznesit.

### **Fushat kryesore të fokusit për këtë KPA janë (a) Qasja në treg dhe (c) Sofistikimi i biznesit**

Rezultatet e përgjithshme të pritura të USAID Compete në të gjithë sektorët janë:

- 1) Përforcimi i sistemeve të tregut për ta rritur konkurrueshmërinë e tregut.
- 2) Përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së akterëve të tregut brenda sistemeve të tregut.

USAID Compete i mbështet aktivitetet në sektorët e fokusit të tij duke i inkurajuar palët e interesit në sektorin privat që të hartojnë dhe zbatojnë nisma përmes një qasjeje adaptive të menaxhimit të projektit. Kjo metodë lejon që aktivitetet dhe burimet të përshtaten sipas ndryshimeve në kushtet e tregut dhe informacionit të ri. Shumë aktivitete fillojnë si projekte pilotimi, duke mundësuar hapësirë për të mësuar, përshtatur dhe testuar përzgjerim pasi të jenë të suksesshme. Ky proces synon të krijojë ndikime më të gjera, të nxisë ndryshime sistematike dhe ta rrisë aftësinë e firmave, organizatave dhe Qeverisë së Kosovës (QK) për t'i zgjidhur problemet në mënyrë efektive.

### **Përshkrim i hollësishëm i programit**

Kjo pjesë ofron një përbledhje të aktiviteteve kryesore të finançuara nga granti që synojnë t'i mbështesin sektorët primar të Kosovës, duke përfshirë përpunimin e drurit, përpunimin e ushqimit, TIK-un dhe ndërtimin e shtëpive të parafabikuara. Këto aktivitete fokusohen në rritjen e konkurrencës së eksportit të këtyre sektorëve duke i adresuar fushat kritike si gatishmëria për eksport, strategjitet e çmimeve, njojuritë e tregut, përshtatja e produktit, efikasiteti funksional, partneritetet strategjike dhe shkëmbimi i njojurive të praktikave të mira të eksportit. Aplikantët kanë fleksibilitetin për ta zgjedhur një ose më shumë nga këto ndërhyrje për projektet e tyre të propozuara, duke ua mundësuar t'i personalizojnë aktivitetet e tyre bazuar në nevojat dhe objektivat e tyre specifike të biznesit. Kjo qasje është krijuar për ta ndihmuar avancimin e pozitës së Kosovës në tregjet ndërkombëtare duke ofruar mbështetje të synuar aty ku është më e nevojshme.

**Penetrimi në treg të ri:** Aktivitete të finançuara nga grantet për të ndihmuar firmat të depërtojnë në tregjet jotradicionale të eksportit. Këto mund të përfshijnë misione tregtare ose aktivitete të tjera të shitjes dhe marketingut që synojnë në mënyrë specifike klientët jashtë partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës (vendet e Ballkanit Perëndimor, Gjermania, Zvicra, etj.). Tregjet e reja mund të përfshijnë vendet në Lindjen e Mesme, Amerikën e Veriut, apo vendet evropiane që nuk janë ende partnerë kryesorë tregtarë për Kosovën.

**Përshtatja e produkteve të eksportit:** Aktivitetet e finançuara nga grantet do të ndihmojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në përshtatjen e produkteve dhe

shërbimeve të tyre për të përmbushur standardet ndërkombëtare, rregulloret dhe preferencat kulturore për tregje specifike të synuara. Kjo do të sigurojë që produktet e prodhuara nga Kosova të janë konkurruese dhe tërheqëse për blerësit e huaj, duke rritur kështu mundësitë e eksportit.

**Përmirësimi i strategjive të çmimeve dhe pozicionimit:** Aktivitetet e finançuara nga granti do të ofrojnë mbështetje për t'i ndihmuar bizneseve të zhvillojnë modele çmimesh konkurruese dhe strategji të pozicionimit në treg që janë të përshtatura për nevojat dhe dinamikat specifike të tregjeve të synuara. Duke i përpunuar këto strategji, kompanitë do të pozicionohen më mirë për t'i tërhequr dhe mbajtur klientët ndërkombëtarë.

**Inkurajimi i partneriteteve strategjike, aleancat dhe iniciativat e përbashkëta:** Aktivitetet e finançuara nga grantet do të promovojnë zhvillimin e partneriteteve strategjike, iniciativave të përbashkëta dhe/ose aleancave të industrisë për të rritur aftësitë e bizneseve kosovare dhe për të zgjeruar shtrirjen e tyre në treg për të depërtuar në tregje specifike të synuara eksportuese. Duke nxitur bashkëpunimin midis kompanive, ofruesve të shërbimeve dhe palëve të interesuara të industrisë, aktivitetet e finançuara nga grantet synojnë të krijojnë mundësi për iniciativa të përbashkëta dhe forma të tjera partneriteti për të mundësuar çasje të përbashkët në treg.

**Shfrytëzimi i njohurive të tregut për planifikim strategjik:** Aktivitetet e finançuara nga grantet do t'i integrojnë njohuritë e tregut dhe hulumtimin për ta mbështetur procesin e vendimmarres strategjike të bizneseve. Këtu do të përfshihet përshtatja e produkteve dhe shërbimeve për t'i përmbushur nevojat e klientëve dhe për të qëndruar në hap me trendet e reja të tregut. Bizneset do të marrin udhëzime për shfrytëzimin e të dhënave për ta nxitur rritjen e tyre strategjike.

**Rritja e efikasitetit funksional:** Aktivitetet e finançuara nga granti do t'i promovojnë proceset e integruar dhe menaxhimin efektiv të burimeve për t'i ndihmuar bizneseve ta rrisin produktivitetin dhe t'i ulin kostot e operimit. Këtu do të përfshihet optimizimi i rrjedhave të brendshme të punës, zbatimi i praktikave të mira dhe shfrytëzimi i teknologjive që mund t'i nxisin përfitimet e efikasitetit.

**Promovimi i shkëmbimit të njohurive rreth praktikave të mira të eksportit:** Aktivitetet e finançuara nga granti do të krijojnë mundësi që bizneset t'i ndajnë përvojat e tyre dhe praktikat e mira në lidhje me eksportin dhe hyrjen në treg. Përmes punëtorive, organizimeve për rrjetëzim dhe nismave të të mësuarit nga kolegët, kompanitë do të mund të mësojnë nga njëra-tjetra dhe bashkërisht t'i rrisin kapacitetet e tyre për të pasur sukses në tregjet ndërkombëtare.

### **Grupi i synuar**

Grupi i synuara i përfituesve për aktivitetet e finançuara nga granti përfshin organizatat vendore, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), shoqatat e industrisë, organizatat me bazë në diasporë dhe konsorciumet e kompanive që veprojnë brenda sektorëve kyç të Përpunimit të Drurit, Përpunimit të Ushqimit, TIK-ut dhe Ndërtimit të Shtëpisë të Parafabrikuara. Më konkretisht, përfituesit përfundimtarë duhet të janë biznese që janë të orientuara drejt eksportit ose që kanë potencial për të hyrë në tregjet ndërkombëtare

dhe janë të gatshme të përmirësojnë konkurrueshmërinë dhe efikasitetin e tyre funksional. Në veçanti, grantet janë të destinuara për bizneset që shfaqin përkushtim ndaj inovacionit, bashkëpunimit dhe rritjes së qëndrueshme, duke përfshirë ato që udhëhiqen nga grupet e pafavorizuara si gratë dhe pakicat. Po ashtu, inkurajohen të marrin pjesë edhe shoqatat e bizneseve dhe firmat e konsulencës. Qëllimi është që të sigurohet se një varg i gjërë akterësh përfitojnë nga aktivitetet e grantit të cilët janë të përkushtuara që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe integrimin e saj në tregjet globale.

### **Aktivitetet e planifikuara**

Aktivitetet e planifikuara nga zbatuesit e përzgjedhur të aktiviteteve të grantit, në bashkëpunim me kompanitë përfituese, duhet t'i përfshijnë një apo më shumë nga këto në vijim (lista nuk është e plotë):

- **Mbështetje dhe mentorim i përshtatur:** Do të ofrohet mbështetje dhe mentorim i personalizuar për t'iu ndihmuar kompanive t'i përmirësojnë proceset e tyre funksionale. Kjo do të fokusohet në përmirësimin e praktikave të dokumentacionit, sigurimin e pajtueshmërisë rregullatore dhe përbushjen e parakushteve të eksportit.
- **Zhvillimi i udhëzuesve dhe instrumenteve burimore:** Do të zhvillohen udhëzues dhe instrumente të thjeshta burimore për t'iu ndihmuar bizneseve të përgatiten për hyrjen në tregje të reja ose për tu zgjeruar brenda atyre ekzistuese. Këta udhëzues do të ofrojnë informata praktike dhe udhëzime hap pas hapi.
- **Misionet tregtare dhe organizimet e rrjetëzimit:** Misionet tregtare dhe organizimet e rrjetëzimit do të organizohen për t'iu dhënë bizneseve mundësinë t'i shfaqin ofertat e tyre dhe të krijojnë lidhje të vlefshme në rajone të reja. Këto organizime do të shërbejnë si platformë për krijimin e kontakteve dhe eksplorimin e mundësive të tregut.
- **Mundësitë e mësimit nga kolegët:** Do të krijojen mundësi për të mësuar nga kolegët, duke iu mundëuar bizneseve t'i ndajnë praktikat e tyre në lidhje me përmirësimet operacionale. Këto aktivitete do ta lehtësojnë shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërmjet pjesëmarrësve.
- **Zhvillimi i ofertave me vlera të ndryshme:** Bizneset do të marrin mbështetje në zhvillimin e ofertave me vlera të ndryshme për t'u harmonizuar me nevojat konkrete të tregjeve të synuara. Kjo do ta rrisë pozicionimin e brendit të tyre dhe përshtatjen në ato tregje.
- **Hulumtimi i tregut:** Realizimi i hulumtimit gjithëpërfshirës të tregut për t'iu ndihmuar kompanive t'i identifikojnë tregjet e mundshme për produktet dhe shërbimet e tyre. Ky hulumtim do të përfshijë analizimin e madhësisë së tregut, klientëve të synuar dhe konkurrentëve për të marrë vendime të informuara.

- Aktivitetet e rrjetëzimit:** Lehtësimi i mundësive të rrjetëzimit duke iu ndihmuar bizneset të ndërtojnë marrëdhënie me klientët, furnitorët dhe shpërndarësit e mundshëm në tregjet e synuara. Kjo do të bëhet përmes pjesëmarries në shfaqje tregtare, konferanca, ngjarje të industrisë dhe ngjarje në dyqane dhe ekspozita.
- Zhvillimi i brendit:** Kompanitë do të asistohen në zhvillimin e një brendi të fuqishëm për t'i dalluar produktet dhe shërbimet e tyre në treg. Këtu do të përfshihet krijimi i një identiteti të bindshëm të brendit, mesazheve dhe materialeve të marketingut.
- Prania elektronike:** Mbështetja e bizneseve për ta ndërtuar një prani të fuqishme në internet, që është thelbësore për sukses në epokën e sotme digitale. Aktivitetet do të përfshijnë krijimin e uebfaqes, përdorimin e mediave sociale në mënyrë efektive dhe themelimin e një platforme elektronike të tregtisë.
- Prania fizike në treg:** Sigurimi i mbështetjes për marrjen me qira të hapësirave në ekspozita ose dyqane për ta krijuar një prani të drejtpërdrejtë në tregje të caktuara të synuara. Kjo prani do t'i ndihmojë bizneseve t'i shfaqin produktet e tyre drejtpërdrejt tek blerësit, duke i rritur gjasat e përzgjedhjes.
- Lehtësimi i qasjes në treg:** Mbështetja e aktiviteteve që e lehtësojnë qasjen në treg për të krijuar një prani afatgjatë për produktet e Kosovës në tregje specifike rajonale siç janë vendet e Lindjes së Mesme dhe të Afrikës. Këto aktivitete synojnë të zhvillojnë strategji të qëndrueshme për hyrje në treg që do t'i pozicionojnë produktet e Kosovës në mënyrë efektive në këto rajone.

### **Shembuj të rezultateve të pritshme**

Aplikantët duhet të propozojnë rezultate realiste dhe të arritshme gjatë gjithë periudhës së grantit, si dhe ndikimin e pritur afatgjatë të aktiviteteve. Lista ilustruese e rezultateve të pritshme është dhënë më poshtë:

- Të paktën 5 biznese raportojnë shitje të reja në tregjet e synuara të eksportit, duke gjeneruar kolektivisht 500,000 dollarë të ardhura shtesë nga drejtimet e reja që rezultojnë nga nismat e mbështetura nga USAID Compete.
- Janë formuar të paktën 2 partneritete të reja, duke çuar në zgjerimin e rrjeteve të shpërndarjes/shitjes, përpjekjet bashkëpunuese të marketingut ose projekte të përbashkëta që krijojnë mundësi të reja biznesi.
- Të paktën 1 kompani tregon gatishmëri të përmirësuar për eksport, duke i filluar aktivitetet e hyrjes në treg, duke siguruar kontrata fillestare ose duke gjeneruar shitje paraprake në rajone të reja.
- Së paku 5 biznese brenda sektorëve të interesit të USAID Compete angazhohen në mënyrë aktive në aktivitetet e shkëmbimit të njohurive dhe rrjetëzimit.

- Të paktën 1 kompani zbaton përmirësime operacionale që i ulin kostot ose e rrisin produktivitetin, duke kursyer kolektivisht rreth 20,000 dollarë mes pjesëmarrësve.

### **Pjesa 2 – Informata rreth grantit**

Varësisht prej disponueshmërisë së fondeve, Aktiviteti synon të sigurojë fonde të grantit që do të ndahen për një periudhë të parashikuar prej 4 muajsh. Data e parashikuar e dhëties së grantit është 30 janar 2025 dhe periudha e parashikuar e zbatimit të grantit pritet të jetë shkurt 2025–maj 2025. Projekti parashikon t'i japë deri në katër (4) Grante me shuma fiksë sipas kësaj KPA-je. Sipas grantit me shumë fiksë, të gjitha pagesat do të jenë shuma fiksë që do të paguhen pas përfundimit të fazave të aktivitetit, të cilat do të përcaktohen në detaje gjatë negociatave të marrëveshjes së grantit. Shuma e grantit për aplikim të suksesshëm do të jetë deri në 80,000 EUR me fondin total të disponueshëm për të gjitha grantet prej 210,000 EUR.

**Aplikantët e suksesshëm inkurajohen ta mbulojnë një pjesë të kostos nga kostoja e përgjithshme e aktivitetit.**

### **Pjesa 3 – Informata rreth kualifikimit**

Të gjitha grantet e lëshuara sipas kësaj KPA-je do t'iu nënshtronen kushteve të kualifikimit të parapara si më poshtë. Organizatat që kualifikohen janë:

- Të regjistruara ligjërisht në Kosovë ose subjekte, institucionë apo organizata me bazë në SHBA. Organizatat nga shtetet e treta mund të merren parasysh sipas rasteve.
- Organizatat jo-fitimprurëse/OJQ-të, shoqatat dhe odat, agjencitë e zhvillimit rajonal, institucionet arsimore publike (institutet, shërbimet plotësuese, etj.), ose organizatat tregtare dhe/ose fitimprurëse që e kuptojnë se asnje fitim ose tarifë nuk do të lejohet sipas marrëveshjes së grantit.

**Aplikantët e paraparë janë** organizatat vendore, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), shoqatat e industrisë, organizatat me bazë në diasporë dhe konsorciumet e kompanive që veprojnë brenda sektorëve kyç të Përpunimit të Drurit, Përpunimit të Ushqimit, TIK-ut dhe Ndërtimit të Shtëpisë të Parafabrikuara.

Organizatat që mund të aplikojnë duhet të janë në gjendje ta respektojnë dhe ta arrijnë pëershkrimin e propozuar të programit, duke përfshirë qëllimet dhe objektivat, të shfaqin menaxhim të shëndoshë financier, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi kontrollesh që i mbron asetat dhe mbron nga mashtrimi dhe shpërdorimi dhe të kenë histori të kënaqshme të performancës dhe të integritetit dhe etikës së biznesit.

Organizatat që nuk mund të aplikojnë përfshijnë:

- Individët.
- Partitë politike apo institucionet.
- Organizatat që avokojnë, promovojnë apo nxisin politika anti-demokratike apo aktivitete të jashtëligjshme.

- Organizatat që synojnë ta përdorin financimin për qëllime religjioze.
- Subjektet që kanë abuzuar me fondet e USAID-it në të kaluarën.
- Subjektet që janë në listën e palëve të përjashtuara nga programet federale të prokurimit dhe jo-prokurimit ose nga Komiteti i Sanksioneve të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara ose që kanë pronarë apo menaxherë që janë të përjashtuar në këtë mënyrë.

Para dhënisë së grantit sipas kësaj KPA-je, aplikantëve të suksesshëm do t'u kërkohet ta nënshkruajnë një Certifikatë në lidhje me financimin e terrorizmit që vërteton se organizata e aplikantit nuk ofron dhe nuk ka ofruar asnjëherë ndihmë për terroristët për aktivitete terroriste. Aplikantëve të suksesshëm mund t'i kërkohet edhe të nënshkruajnë Certifikata të tjera të zbatueshme për grantin. Certifikatat janë bashkangjitur si Shtojca C.

Para dhënisë së grantit sipas kësaj KPA-je, aplikantët e suksesshëm do t'i nënshتروhen edhe vlerësimi të përgjegjësisë para dhënisë së grantit, i cili do të kryhet nga USAID Compete. Duke e realizuar këtë vlerësim, Aktiviteti do të përcaktojë nëse aplikanti posedon kapacitetin organizativ, kapacitetin finanziar, kontrolllet e brendshme, sistemet e prokurimit (nëse është e nevojshme) dhe historinë e performancës së kaluar në mënyrë që t'i zbatojë me sukses aktivitetet e grantit. Vetëm organizatat që janë përcaktuar të janë përgjegjëse do të kenë të drejtë të marrin grant.

Nuk do të merret parasysh asnjë aktivitet që ka ndikim negativ mjedisor që nuk është trajtuar.

#### Kushtet minimale për aplikantët

Kushtet	Dokumentet vërtetuese
<b>Pajtueshmëria administrative</b>	
Subjekt i regjistruar ligjërisht	Certifikata e regjistrimit
<b>Kapaciteti profesional dhe teknik</b>	
Aplikanti duhet të ketë zbatuar iniciativa të ngjashme në të kaluarën ose të ketë marrë pjesë në projekte që përfshijnë eksportin (panaire tregtare, organizime B2B).	Çdo informatë mbështetëse përkatëse që ofron dëshmi të kapacitetit të aplikacionit për të zbatuar aktivitetet e propozuara
Aplikanti propozon të paktën 2 (dy) pjesëtarë të stafit profesional në fushën përkatëse për objektivat dhe aktivitetet e propozuara.	CV-të e 2 pjesëtarëve të stafit profesional

#### Pjesa 4: Sesioni informues

Projekti synon ta mbajë një sesion informues duke iu mundësuar të gjithë të interesuarve për të aplikuar në KPA të bëjnë pyetje rreth procesit të aplikimit. Sesioni informues do të mbahet ditën e hënë, 9 dhjetor 2024, nga ora 11:00 – 12:30 në ambientet e Projektit në Rr. Ukshin Hoti Nr 120 Objekti C3/3/b kat. I. Të gjithë aplikantët e interesuar janë të

mirëpritur të marrin pjesë dhe duhet të rezervojnë një vend përmes emailit kosovogrants@dt-global.com deri të premten, 6 dhjetor 2024, për të siguruar disponueshmërinë e hapësirës. Pjesëmarrësit mund të marrin pjesë në prezantim edhe përmes [Microsoft Teams](#).

### **Pjesa 5 – Informata rreth aplikimit dhe dorëzimit të aplikacioneve**

Aplikantët duhet t'i dorëzojnë aplikacionet e shkruara tek Menaxheri/ja i/e Grantit **përmes dërgimit me email** në këtë email adresë të projektit: kosovogrants@dt-global.com.

Aplikacioni duhet të shënohet në mënyrë të qartë në subjektin e email-it me numrin përkatës të KPA-së, pra RFA#03-2024. Data e fundit për dorëzimin e aplikacioneve është të mërkuren, më 8 janar 2025 dhe ora e fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 17:00 sipas kohës lokale. Aplikimet e vonuara nuk do të merren parasysh.

Të gjitha aplikimet që i përgjigjen kësaj KPA-je përbëhen prej **propozimit teknik** dhe **propozimit të buxhetit**. Propozimet teknike dhe financiare duhet të dorëzohen si dosje të ndara.

#### **Propozimi teknik**

Propozimi teknik nuk duhet të jetë më i gjatë se 10 faqe. Aplikacionet e paraqitura me më shumë se 10 faqe nuk do të merren parasysh. Të gjitha dokumentet mbështetëse dhe CV-të e pjesëtarëve kryesorë të stafit të propozuar, të cilat aplikantët duhet t'i dorëzojnë (shih Shtojcën A - Formulari i Aplikimit – Propozimi Teknik), nuk do të llogariten në kufirin prej 10 faqesh. Propozimi teknik duhet të dorëzohet në gjuhën angleze, ndërsa dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen në gjuhën origjinale ose në anglisht.

Propozimi teknik do të përbëhet si në vijim:

- 1. Përshkrimi i aktiviteteve të planifikuara dhe metodologjia e propozuar për zbatimin e aktiviteteve (afro 6-7 faqe)**
  - Tregoni objektivat dhe përcaktoni aktivitetet sipas secilit objektiv, duke përfshirë rezultatet dhe ndikimin e parashikuar
  - Përgatitni një afat kohor ku përcaktohet koha, sekuenca dhe kohëzgjatja e aktiviteteve të propozuara, duke marrë parasysh kohën e mobilizimit. Propozoni një plan të përpunuar dhe të detajuar të zbatimit
  - Përshkruani se si do të realizohen “arritjet e pritshme” të përshkruara në pjesën 1.
- 2. Përshkrimi i aplikantit/organizatave (afro 2-3 faqe)**
  - Përshkruani përvojën e mëparshme të aplikantit në zbatimin e programeve të ngjashme (të demonstruara me dëshmi vërtetuese)
  - Siguroni një listë të stafit profesional me përvojë të dëshmuar për zbatimin e projektit.
- 3. Lista e propozuar e stafit profesional me përvojë të dëshmuar për zbatimin e projektit**

## Propozimi teknik duhet të dorëzohet duke përdorur **Shtojcën A – Formulari i Aplikimit – Propozimi Teknik.**

### ***Propozimi i kostos***

Propozimi i kostos do të dorëzohet si dosje e veçantë nga propozimi teknik. Aplikantët këshillohen ta plotësojnë formularin e buxhetit sa më të detajuar që të jetë e mundur. Shumat paushall nuk do të pranohen. Aplikantët lejohen të shtojnë rreshta të ri dhe t'i modifikojnë linjat buxhetore (jo Titujt e Buxhetit) sipas nevojave të aktiviteteve të propozimit. Aplikantët duhet ta japin edhe një përshkrim të detajuar të buxhetit.

Formati i kërkuar për buxhetin është përfshirë si **Shtojca B - Formulari i Buxhetit.**

Sipas Dispozitave Standarde Obligative për Përfituesit jashtë SHBA-ve, Përfituesit Joqeveritar, kërkесат uniforme administrative mbi parimet e kostos për çmimet federale 2 CFR 200, Nënpjesa E, Parimet e kostos dhe Parimet e Kostos për Organizatat Komerciale/Fitimprurëse (48 CFR 31.2 Rregulloret Federale të Blerjes), taksat, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, nuk janë kosto të lejueshme kur ekziston një mekanizëm i përjashtimit ose i rimburimit të këtyre taksave. Ju lutemi mos e buxhetoni koston e TVSH-së në ndarjen e buxhetit të projektit për kostot e bëra brenda Kosovës.

### ***Pjesa 6 – Informata rreth vlerësimit të aplikacioneve***

Aplikacionet do të vlerësohen në përputhje me kriteret e përcaktuara më poshtë. Kriteret janë përshtatur me kërkесат e kësaj KPA-je. Aplikuesit duhet ta kenë parasysh se këto kriterë shërbejnë për: (a) identifikimin e çështjeve të rëndësishme që aplikantët duhet t'i adresojnë në aplikacionet e tyre dhe (b) vendosin standardin sipas të cilit do të vlerësohen të gjitha aplikacionet.

Sipas nevojës, Projekti mund të kërkojë sqarime dhe materiale shtesë nga Aplikantët, aplikacionet e të cilëve kanë gjasa të arsyeshme për t'u përzgjedhur për Grantin. Hyrja në bisedime duhet të shihet si pjesë e procesit të vlerësimit dhe nuk duhet të konsiderohet si tregues i vendimit ose angazhimit nga ana e projektit për t'i dhënë grant aplikantëve me të cilët zhvillohen bisedimet.

Aplikacionet do të vlerësohen nga Komisioni për Përzgjedhjen e Granteve (KPG) në bazë të 100 pikëve të mundshme. Vlerësimi i pjesëve të ndryshme do të bëhet si në vijim:

#### **Kriteret e vlerësimit:**

- **Përshkrimi i aktiviteteve të propozuara (30 pikë):** Vlerëson qartësinë, fizibilitetin dhe harmonizimin e aktiviteteve të propozuara me qëllimet e projektit. Pikët e larta jepen për plane të strukturuara mirë që demonstrojnë hapa praktikë drejt arritjes së objektivave.
- **Profili dhe historia e aplikantit (15 pikë):** Vlerëson përvojën përkatëse të aplikantit dhe aftësinë e dëshmuar për ta ekzekutar projektin. Pikët jepen bazuar në arritjet dhe ekspertizën e mëparshme që tregojnë kapacitet të fortë për sukses.
- **Ndikimi dhe vlera e rezultateve të projektuar (eksporti) (25 pikë):** Përqendrohet në rezultatet e pritura, me theks në ritjen realiste, të matshme dhe

rezultate të tjera me ndikim që i nënshtronen fushës së aktivitetit. Rezultatet më të larta jepen për qëllime të qarta dhe të arritshme që kontribuojnë në zgjerimin e tregut, veçanërisht në tregje jo-tradicionale të eksportit.

- **Efektiviteti i kostos dhe arsyetimi i buxhetit (20 pikë):** Vlerëson arsyetimin e buxhetit dhe përdorimin efikas të burimeve. Pikët jepen për buxhetin e menduar mirë që e rrit ndikimin brenda fushëveprimit të programit.
- **Qëndrueshmëria dhe ndikimi afatgjatë (10 pikë):** Vlerëson se sa mund të ruhet ndikimi i projektit me kalimin e kohës. Pikët jepen për planet e mirëfillta që dëshmojnë benefite përej kohëzgjatjes së aktivitetit.

Përzgjedhja e aplikantit për grantin do të bëhet nga KPG i Projektit. Para se të jepet marrëveshja e grantit, Projekti duhet ta marrë miratimin paraprak nga USAID.

### **Sekzioni 7 – Informata rreth dhënies dhe administrimit të grantit Identifikuesi Unik i Subjektit (IUS):**

Duke filluar nga 4 prilli 2022, numri unik identifikues i subjektit (IUS) nga SAM.gov është identifikuesi autoritar për ata që bëjnë biznes me qeverinë federale. Numri DUNS nuk është më i vlefshëm për identifikimin e çmimit federal. Numri unik identifikues i subjektit krijohet në SAM.gov (ëëë.sam.gov). Nëse jeni regjistruar në SAM.gov (aktiv ose jo), tashmë e keni numrin unik identifikues të subjektit. Mund të shihet në SAM.gov.

Ndërsa aplikantët mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre pa numrin NUI, megjithatë, përfituesit e granteve duhet ta paraqesin NUI-in para se të marrin financim.

Për shkak të vonesave në përpunimin e NUI-ve, aplikantët inkurajohen të aplikojnë për numrin më herët.

#### **Njoftimet:**

Aplikanti (aplikantët) e suksesshëm do të marrin njoftim me shkrim nga Menaxheri i Granteve duke e informuar aplikantin (aplikantët) se projekti ose synon t'ia japë një grant aplikantit pa negociata ose se projekti synon ta angazhojë aplikantin (aplikantët) në bisedime të mëtejshme në lidhje me një grant të mundshëm. Bisadimet e kryera pas marrjes së aplikacionit nuk përbëjnë detyrim nga ana e projektit për të dhënë grant. Aplikantët e pasuksesshëm do të njoftohen me shkrim nga Menaxheri i Granteve.

Çdo grant që rezulton do t'i nënshtronet kushteve dhe kriterieve të Kontratës kryesore për Aktiviteti USAID Kosovo Compete, Dispozitat Standarde për Përfituesit Jo-Qeveritar jashtë SHBA-ve.

#### **Vlerësimet para dhënies së grantit**

Projekti duhet të jetë plotësisht i bindur që aplikanti ka kapacitetin për të performuar në mënyrë adekuate në përputhje me parimet e përcaktuara nga USAID. Granti mund të jepet vetëm pasi Projekti ta bëjë një vlerësim pozitiv se aplikanti zotëron, ose ka aftësinë për ta fituar, kompetencën e nevojshme menaxheriale për ta kryer aktivitetin e grantit dhe do t'i praktikojë metodat e përgjegjshmërisë të dakorduara reciprokisht për fondet dhe asetet e tjera të finançuara nga USAID. Projekti, së paku, do ta kryejë një vlerësim para

dhënes së grantit për aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë, në mënyrë që t'i përcaktojë përgjegjësinë.

Lëshimi i kësaj KPA-je nuk përbën angazhim për dhënie të grantit nga ana e Projektit ose Qeverisë së SHBA-së, as nuk e detyron Projektin ose Qeverinë e SHBA-së të paguajë për kostot e shkaktuara në përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacioneve.

### ***Section 8: Shtojcat***

Shtojca A: Formulari i Aplikimit – Propozimi Teknik

Shtojca B: Formulari i Buxhetit

Shtojca C: Certifikatat